



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/ 180/22

Datë: 04.03. 2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe nenit 3 paragrafët 1,2,3,4 dhe 5 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.09.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për formimin e Grupit të punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023

I. Me këtë vendim formohet Grupi i punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023 /në tekstin e mëtejme Grupi i punës/.

II. Grupi i punës ka për detyrë që të hartojë (projekt) Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023 në përputhje me nenin 3 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut.

III. Grupin e punës e përbëjnë nga një përfaqësues i subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, , një përfaqësues nga ekzekutivi.

IV. Grupi punues përbëhet nga:

1. Shpejtim Gacaferi -Kryetar (LDK), Kryesues i Kuvendit,
2. Albertina Gacaferi -anëtare (LDK), Kuvendi Komunal
3. Erleta Qestaj - anëtare (AAK), Kuvendi Komunal
4. Eliza Pepshi -anëtare (LVV), Kuvendi Komunal dhe
5. Leonora Shehu -anëtare nga ekzekutivi

IV. Afati i hartimit të (projekt) Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut është më së largu deri në fund të muajit dhjetor të këtij viti.

V. Pas hartimit të (projekt) Planit të punës nga ana e Grupit të punës, (projekt) Plani i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut

